



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

1339/ Prot
/1

Tiranë, më 15.04.2026

V E N D I M

Nr.42, datë 15.04.2026

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, SIPAS KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 (faza e tretë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, ndryshuar me VKM Nr.784, datë 26.12.2018 dhe VKM Nr. 39, datë 23.01.2019, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 1339 Prot., datë 01.04.2026, në mbledhjen e tij të datës 15.04.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve, sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përfitojnë bursë financiare për vitin akademik 2025 - 2026 (faza e tretë) (sipas tabelës bashkëlidhur).
 2. Efektet financiare të këtij vendimi (për 12 studentë që plotësojnë kriterin) janë në vlerën 670,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetëmijë) lekë.
 3. Pagesa për çdo studentët të kryhet pasi të ketë ardhur konfirmimi nga institucionet përkatëse.
 4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Matilda SHABANI

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar

Edmond KADIU

Anëtar

Blerina DUKA

Anëtar

Altin PRENGA

Anëtar

Ilir KUSI

Anëtar

